



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 144, datë 26.07.2019**

**PËR**

**NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 139, DATË 19.07.2019,  
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR CAKTIM GJYQTARI, NË NJË  
ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR  
MAT”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4, 147/1/A të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në kërkesat e datës 26.07.2019 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për saktësimin e objektit të çështjes dhe në kushtet kur gjatë procedurave të shortit, në funksion të vendimit nr. 139 datë 19.07.2019, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ishte mbajtur parasysh së gjyqtarja Engjëllushe Tahiri kishte pengesë ligjore për gjykimin e një çështjeje të veçantë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 139, datë 19.7.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, pika 2, nënndarja “**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**”, **paragrafi I**, ndryshohet si më poshtë:

“2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Emilion Kertuka, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal”.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarës përkatëse të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**